



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË**

URDHËR
NR. 246, DATË 12. 3. 2018

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË
MIRATIMIT TË MARRËVESHJES HIDROKARBURE, LICENCË
MARRËVESHJES SI DHE AFATET PËRKATËSE

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 5 dhe pikës f, të nenit 9 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993
“Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afatet përkatëse, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Urdhri.
2. “Rregullorja për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, ndryshuar me Urdhrin e Ministrit nr. 121, datë 08.05.2015, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse për sektorin hidrokarbur dhe juridik në MIE, AKBN dhe shoqëria Albpetrol sh.a.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Damian Gjiku

Përgatiti: Enkelejda Laçi, Specialist SPZHH

Ilia Gjermani Përgjegjës i SPZHH

Enea Karakaci, Këshilltar Ligjor

Miratoi: Mehmet Hasalami, Drejtori i DPZHIE

Gentian Këri, Sekretar i Përgjithshëm

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË MIRATIMIT TË
MARRËVESHJES HIDROKARBURE, LICENCË MARRËVESHJES SI DHE
AFATET PËRKATËSE

I. Procedurat për iniciimin e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve bëhen si më poshtë:

1. Me iniciativë të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet (Ministria), nëpërmjet një njoftimi për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrje me anën e aplikimeve. Ministria, AKBN dhe Albpetrol Sh.A. (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol) në këtë rast publikojnë në faqen e tyre të internetit hartën me blloqet e lira apo vendburim/e të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrje me anën e aplikimeve, si dhe formularin e aplikimit. Në formatin e aplikimit duhet të përfshihet edhe afati i dorëzimit të aplikimeve për bllokun/blloqet e lira apo vendburimin/et.
2. Me njoftim të Ministrisë, për të ftuar subjekte të tjera për aplikime, pas dorëzimit të kërkesës, në Ministri, AKBN ose Albpetrol (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol), nga një subjekt për një bllok/blloqe apo vendburim/e të caktuar/a për të cilët nuk ka një njoftim të publikuar. Afati kohor i kësaj ftese është jo më pak se 90 ditë, duke filluar nga data e njoftimit. Ky njoftim publikohet në faqen e internetit të ministrisë, AKBN dhe Albpetrol.

II. Procedura për përgatitjen dhe miratimin e një Marrëveshje Hidrokarbure, nga Ministria, AKBN dhe Albpetrol, sipas zonave që kanë në administrim si dhe afatet kohore të miratimit të tyre janë si më poshtë:

1. Subjektet e interesuara paraqesin pranë Ministrisë, AKBN ose Albpetrol (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol) një aplikim për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure. Në rast aplikimi në Ministri, ai dërgohet për shqyrtim në AKBN ose Albpetrol brenda 10 ditëve.

2. AKBN ose Albpetrol shqyrton aplikimin sipas procedurës së mëposhtme:

i. Në rastin kur në AKBN ose Albpetrol ka aplikim nga një subjekt i vetëm për një bllok ose vendburim të lirë, AKBN ose Albpetrol sipas rastit, brenda 10 ditëve nga marrja e aplikimit, pas afateve kohore të përcaktuar në pikën 1, paraqet në Ministri dokumentacionin e nevojshëm, se bashku me vlerësimin për kapacitetet teknike dhe financiare, si dhe kërkesën për miratimin e fillimit të negociimeve. Ministria jep aprovimin ose jo për fillimin e negociatave brenda 20 ditëve nga marrja e propozimit nga AKBN ose Albpetrol.

ii. Në rast se, ka më shumë se një aplikim për një bllok ose vendburim të lirë, AKBN ose Albpetrol sipas rastit, përcjellin në Ministri dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe

Handwritten signatures and initials at the bottom left of the page.

Handwritten signature or mark at the bottom center of the page.

vlerësimin e tyre bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure. Mbi këtë dokumentacion të paraqitur, Ministria bën vlerësimin e saj për këtë shoqëri.

3 Ministria, për shkak të sigurisë kombëtare, mund të refuzojë lidhjen e një marrëveshje hidrokarbure, në përputhje me kushtet e parashikuara në ligjin nr. 7746/1993 "Për hidrokarburet (kërkimit dhe prodhimit)", të ndryshuar.

4. Në rast miratimi nga Ministria të kërkesës së AKBN ose Albpetrol, me urdhër të ministrit ngrihet grupi negociator, i cili fillon negociatat me subjektin e përzgjedhur fitues nga Ministria për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, në bazë të aplikimit të paraqitur nga subjekti fitues. Në grupin negociator përveç përfaqësuesve të Ministrisë dhe AKBN ose Albpetrol mund të caktohen edhe ekspertë të jashtëm. Pasi palët bien dakord, dokumenti nënshkruhet nga grupi negociator dhe shoqëria aplikuese dhe i përcillet Ministrisë për miratim. Gjatë procesit të negociatave mbahen minutat e takimeve.

5. AKBN apo Albpetrol përcjell Ministrisë për miratim Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit Ministria jep miratimin apo refuzimin e saj për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 20 ditëve nga marrja e dokumentit të nënshkruar të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes. Në rast se Ministria e vlerëson të nevojshme, ky afat mund të zgjatet për aq sa është e nevojshme për të kryer vlerësimin e termave dhe kushteve.

6. Në rast miratimi të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, grupi negociator fillon procesin e negociimit të tekstit të Marrëveshjes Hidrokarbure. Procesi përfundon kur drafti përfundimtar i Marrëveshjes Hidrokarbure, në gjuhën shqipe dhe angleze, firmoset në çdo faqe nga grupi negociator dhe subjekti i interesuar. Në rast se grupi negociator e gjykon të nevojshme, kryhen oponenca, më tej drafti sipas rastit rishikohet. Kur drafti çohet për oponencë, atëherë rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhen brenda 20 ditëve nga data e marrjes së oponencës. Grupi negociator i përcjellë Ministrisë për miratim draftin përfundimtar të Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 15 ditëve nga data e firmosjes së tij, në çdo faqe nga palët. Drafti i përfunduar i përcillet Ministrisë për miratim.

7. Ministria e dërgon paraprakisht draftin për mendim në Ministrinë e Financave dhe Avokaturën e Shtetit, si dhe mund të dërgohet për oponencë në institucione të tjera nëse e gjykon të nevojshme. Kur drafti çohet për oponencë, atëherë rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhet brenda 20 ditëve nga data e marrjes së oponencës. Rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhen brenda 20 ditëve nga data e marrjes së mendimit nga Ministria e Financave dhe Avokatura e Shtetit.

Në rast vërejtjesh nga oponenca e kryer ose institucionet e sipërpërmendura dhe kur ato gjykohen si të drejta, drafti përcillet për rinegociim të grupi negociator dhe shoqëria aplikuese.

8. Pas kryerjes së rinegociimeve, Albpetrol e përcjell draftin e rinegociuar për miratim, ndërsa AKBN për miratim dhe nënshkrim tek Ministri.

Handwritten signatures:
Two signatures on the left margin, one above the other, and a third signature below them.

Handwritten signature:
A single signature in the bottom center of the page.

9. Për zonat që administrohen nga AKBN, drafti i rinegociuar dërgohet në Ministri brenda 10 ditëve për nënshkrim.

Ministri jep miratimin për nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure për zonat që administron Albpetrol, brenda 20 ditëve nga dërgimi. Albpetrol nënshkruan Marrëveshjen Hidrokarbure brenda 10 ditëve nga ky miratim.

10. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, sipas pikës 9 të këtij kreu, nga ana e Ministrisë nis procedura për miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar.

III. Procedura për miratimin e Licencë Marrëveshjes

1. Pas miratimit të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure nga Ministria, Albpetrol paraqet brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i tyre pranë AKBN kërkesën për t'u pajisur me Licencë Marrëveshje nga Ministri.

2. AKBN përgatit dhe i dërgon Albpetrol brenda 20 ditësh nga marrja e kërkesës nga Albpetrol, draftin e Licencë Marrëveshjes. Drafti i Licencë Marrëveshjes diskutohet brenda një afati 20 ditor, ndërmjet Albpetrol dhe AKBN dhe me pas firmoset në çdo faqe.

3. Drafti përfundimtar i paraqitet Ministrisë për miratim dhe nënshkrim brenda 10 ditëve nga përfundimi i diskutimeve. Ministri brenda 10 ditëve nënshkruan apo kërkon bërjen e ndryshimeve. Në rast se Ministria e vlerëson të nevojshme, ky afat mund të zgjatet për aq sa është e nevojshme për të kryer vlerësimin e termave dhe kushteve.

4. Në rast se Ministri kërkon ndryshimin e draftit, AKBN dhe Albpetrol bëjnë reflektimet e nevojshme brenda 20 ditëve dhe drafti i rishikuar i Licencë Marrëveshjes ri-paraqitet për nënshkrim në Ministri.

5. Licencë Marrëveshja nënshkruhet nga Ministri ose nga një person i autorizuar me shkrim prej tij, dhe Albpetrol, brenda 10 ditësh nga dhënia e miratimit për tekstin e Marrëveshjes Hidrokarbure përkatëse.

Quam
dh
Ez